

BACHELOR NË “FIZIOTERAPI”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” synon të pajisë studentët me aftësi për të ofruar kujdes të personalizuar për pacientët ambulatorë dhe ata të shtruar në spital, duke u mbështetur në njohuri të avancuara dhe të përditësuara mbi rehabilitimin. Ky program i pajis studentët me aftësitë për të zhvilluar një qasje profesionale në fizioterapi duke theksuar aftësitë për bashkëpunim në ekipe multidisciplinare dhe zbatimin e praktikave të bazuara në plane dhe protokolle që kanë mbështetje shkencore. Përmes këtij programi studentët përgatiten për të ndërmarrë detyra profesionale me përgjegjësi të lartë, duke respektuar standardet etike dhe deontologjike në përputhje me profesionin e fizioterapistit.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të programit Bachelor në “Fizioterapi”, studenti do të jetë i aftë të:

- Identifikojë, përcaktojë dhe menaxhojë sfidat e praktikës profesionale duke përdorur mendimin kritik, logjik dhe analitik.
- Kuptojë, analizojë dhe integrojnë njohuritë e programit dhe t'i zbatojë ato në mjediset laboratorike ose në trajtimin e pacientëve, qoftë realë apo të simuluar.
- Tregojë profesionalizëm dhe përgjegjësi etike me një nivel të lartë besimi, integriteti dhe përkushtimi ndaj mirëqenies sociale, duke bashkëpunuar me ekipe multidisciplinare.
- Analizojë dhe interpretojë vlerësimin fizik të pacientit, të vendosë diagnozën dhe të përcaktojë objektivat afatshkurtra dhe afatgjata për terapinë.
- Zgjedhë dhe zbatojë në mënyrë të sigurt dhe efikase strategjitë e rehabilitimit, duke u bazuar në të dhënat dhe provat shkencore.
- Hartojë një plan të sigurt rehabilitimi dhe të dokumentojë me saktësi progresin e tij gjatë gjithë procesit të kujdesit për pacientët.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Studentët që përfundojnë programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” mund të punësohen si:

- a. Fizioterapist në spitale publike dhe private
- b. Fizioterapist në klinika private
- c. Fizioterapist në qendrat e kujdesit për të moshuarit
- d. Fizioterapist në organizata jo-fitimprurëse
- e. Fizioterapist në mjedise komunitare dhe në shërbimin shtëpiak
- f. Fizioterapist në fushën e fizioterapisë në vendin e punës (occupational physiotherapy)
- g. Fizioterapist në qendra sportive.

Mbajtësi i diplomës ka të drejtë të licencohet për ushtrimin e profesionit të rregulluar të fizioterapistit, në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.



BACHELOR "FIZIOTERAPI" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15-20% / 35 ECTS

1	I	1	Biologji Humane	5
2	II	1	Hyrje në Psikologji	6
3	I	1	Shkrim Akademik + Metodat e kërkimit	8
4	I	1	Hyrje në Sociologji	6
6	I	2	Statistikë	6
7	I	1	Biofizikë	4
				35

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/93 ECTS

1	I	1	Anatomi 1	5
2	I	2	Anatomi 2	5
3	I	2	Vlerësim dhe teknikat fizioterapeutike	6
4	II	1	Biomekanike dhe Kinezologji	8
5	II	1	Principet e sëmundjeve të brendshme	6
6	II	2	Rehabilitimi në ortopedi dhe prostetikë	6
7	II	1	Fiziologji	6
8	III	1	Principet e obstetrikë- gjinekologji dhe rehabilitim	6
9	II	2	Principet e neurologji dhe rehabilitim	6
10	III	1	Principet e geriatisë dhe rehabilitim	6
11	II	2	Principet e pediatisë dhe rehabilitim	6
12	II	2	Terapi fizike	5
13	II	1-2	Praktikë ndërlëndore 1-2	8
14	III	1-2	Praktikë ndërlëndore 3-4	8
15	III	2	Mjekësi sportive	6
				93

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/22 ECTS

1	I	2	Histologji dhe Anatomi patologjike e përgjithshme	6
2	III	1	Deontologji, etikë dhe legjislacioni mjekësor	6
3	III	2	Shëndet publik	6
4	III	2	Farmakologji	5
5	II	2	Biokimi mjekësore	5
6	II/III	1-2	Honors Course	6
				22

D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/23 ECTS

1	I	1	Terminologji mjekësore	4
2	I	2	Anglisht	5
3	III	1	Praktikë Klinike I	6
4	III	2	Praktikë Klinike II	8
				23

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm përfundimtar	7
---	-----	---	---	---

TOTAL ECTS 180